



Prishtinë: 02.09.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1385_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2170_04_21**;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 09.06.2021;

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit H.A nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2170_04_21, i datës 30.04.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 30.04.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2170_04_21, me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit H.A nga Komuna e Prishtina lidhur me kontestimin e faturës për periudhën 05/2014 dhe e ka obliguar KESCO-n që t'i ofroj konsumatorit një marrëveshje pagese për një periudhë dhjetë (10) mujore.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori H.A, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, për shkak të:

- Konsumatori nuk pajtohet me vendimin e DMK-së, pasi që beson që nuk e ka krijuar atë borxh.
- Konsumatori pretendon që faturat i ka paguar me rregull dhe kërkon një zgjidhje.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes provat si në vijim: Fatura nr.05140DPR-28636 e datës 27.05.2014, Ankesa e konsumatorit në KESCO e datës 01.04.2015, Përgjigja e KESCO-s e datës 16.01.2019, Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 19.02.2019, Procesverbali inspektimit nr. 0705757 e datës 23.01.2019, Vendimin e DMK-së me nr. ZRrE/DMK_V_2170_04_21 të dt. 30.04.2021, Ankesën e konsumatorit të dt.09.06.21 dhe Rrjedha e Energjisë Elektrike.



Pas administrimit të të gjitha këtyre provave veç e veç, Bordi i ZRRë-së ka konstatuar këtë gjendje faktike:

- Departamenti i faturimit në KESCO me datë 27.05.2014 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën maj 2014 me shpenzim prej **6,323 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **331.91€**.
- Me datë 01.04.2015 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kërkuar që ti behet ri shqyrtimi i faturave për periudhën maj 2014, për shkak të dyshimit të leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr.08195334.
- Me datë 20.06.2015 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve në njehsorin elektrik nr.08195334 prej TL=037850 kWh dhe TU=016529 kWh.
- Bordi konstaton se bazuar në shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e inspektimit vërtetohet se shpenzimet e konsumatorit të evidentuara në CCP për periudhën maj dhe qershor 2015 përputhen me gjendjen e evidentuar në procesverbalin e inspektimit.

Bordi ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike e në veçanti për periudhën 10/2013 deri më 05/2014 dhe konstaton se konsumatori është faturuar pa matje përkatësisht në mënyrë të vlerësuar. Po ashtu në rrjedhën e energjisë elektrike vërehet se konsumatorit në periudhën maj 2014 i janë faturuar kWh e grumbulluar për periudhën dhjetë mujore, si dhe pas periudhës maj 2014 i është përmirësuar edhe gjendja e faturimit në CCP. Faturimi i periudhës maj 2014 krahasuar edhe me të gjitha periudhat e tjera të faturimit nuk paraqet faturim real të shpenzimeve mujore të konsumatorit, por faturim të shpenzimit të energjisë elektrike të grumbulluar. DMK duke pasur parasysh se konsumatori për periudhën maj 2014 është faturuar me grumbullim të shpenzimit të energjisë elektrike, ka bërë shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 10/2013 deri më 05/2014 dhe se pas shpërndarjes nuk rezulton se duhet t'i bëhet korigjim financiar konsumatorit.

Andaj, nga sa u tha më sipër, Bordi i ZRRë-së thekson se sipas nenit 5, paragrafi 3.9 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, thuhet se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të: *“sigurojë lexim të saktë dhe të Rregullt të njehsorëve”*, gjithashtu sipas nenit 3 të Procedurës së leximit dhe faturimit theksohet se: *“Leximi i njehsorëve duhet të përfshijë periudhën një mujore të shpenzimit të energjisë”*. Duhet theksuar se në nenin 25, paragrafi 1 i Rregullës në fjalë thekson se: *“Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji”*.

Duhet theksuar se në rastet kur nuk kemi lexim dhe faturim të rregullt të pikës matëse atëherë KESCO bazuar në të dhënat e leximit të pikës matëse bënë edhe korigjimet eventuale të konsumatorëve. Kjo çështje është e rregulluar në nenin 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”*. Mirëpo ashtu siç u theksua edhe më lartë DMK pas shpërndarjes së shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 10/2013 deri më 05/2014 ka vërejtur se nuk rezulton se duhet t'i bëhet korigjim financiar konsumatorit, mirëpo për shkak të mos leximit të rregullt të pikës



matëse dhe grumbullimit të saj në një muaj, atëherë KESCO duhet t'i ofroj konsumatorit një marrëveshje pagese me këste për një periudhë dhjetë (10) mujore.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit H.A dhe
- Arkivit të ZRRE-së.